

Vendim nr. 225 datë 22.09.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Marjana Semini,	Anëtare
Ilir Toska,	Anëtar

në datën 22.09.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 10 (P) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: PËLLUMB QESKA

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 41-2015-1064 (536), datë 16.03.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; nr. 259, datë 06.10.2015 të Gjykatës së Apelit Korçë; nr. 00-2024-209, datë 17.01.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Pranimi i të gjitha kërtimeve në objektin e kërkesëpadisë të paraqitur përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Dëmshpërblimi për fitimin e munguar nga paditësit të llogaritet për periudhën nga viti 2004 deri në ekzekutimin e vendimit.

Të llogaritet dëmi pasuror.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, pikat 1 dhe 2, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokolli nr.1 i saj; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është një nga trashëgimtarët ligjorë të trashëgimlënësit S.Q. (babai i tij), i cili ka pasur në pronësi një shtëpi mbi një truall me sipërfaqe 316 m², të ndodhur në qytetin e Korçës, me kufij të përcaktuar. Kjo pasuri i është shpronësuar nga shteti me qëllim zhvillimin urbanistik të qytetit, duke ndërtuar në atë vend një pallat banimi 7-katësh. Për këtë pronë, mbi kërkesën e kërkuesit, bazuar në ligjin nr.7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve” (*ligji nr.7698/1994*), Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP), Korçë, me vendimin nr.336, datë 10.06.1994 (*vendimi nr. 336/1994*), ka vendosur njohjen e së drejtës së pronësisë ish-pronarit S.Q. dhe kompensimin me letra me vlerë të trashëgimtarëve të tij, me arsyetimin se trualli nuk ishte i lirë, por i zënë në mënyrë të përhershme me ndërtime, pallati i banimit. Ky vendim nuk është kundërshtuar gjyqësisht në atë kohë nga trashëgimtarët e ish-pronarit S.Q.

2. Pas zhvillimit të një tenderi të hapur ndërkombëtar për privatizimin dhe shitjen e aksioneve të Bankës së Kursimeve sh.a., Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 1, datë 07.01.2004, ka vendosur miratimin e kontratës së shitblerjes ndërmjet Ministrisë së Financave, në cilësinë e aksionarit të Bankës së Kursimeve të Shqipërisë, dhe shoqërisë “Raiffeisen Zentralbank Österreich Aktiengesellschaft” (regjistruar më pas si “Raiffeisen Bank” sh.a.), duke i kaluar kësaj të fundit 100 % të aksioneve të Bankës së Kursimeve të Shqipërisë, kundrejt çmimit prej 126.000.000 USD. Në vijim, sipas delegimit të dhënë me këtë vendim, ministri i Financave ka nënshkruar kontratën e miratuar të shitblerjes, sipas së cilës blerësit i është kaluar pronësia edhe për objektin “Agjencia Bankare nr. 2, Korçë”.

3. Për arsye se objekti “Agjencia Bankare nr. 2”, Korçë ndodhet në katin e parë të pallatit 7-katësh të ndërtuar në truallin e ish-pronarit S.Q. dhe që për këtë shkak trualli nuk iu kthye trashëgimtarëve të tij, por atyre iu njoh e drejta e kompensimit me obligacione shtetërore, në datën 06.06.2008 kërkuesi i është drejtuar me një kërkesë Ministrisë Financave, duke i kërkuar që ambienti t’u jepej trashëgimtareve të ish-pronarit S.Q., për shkak se Raiffeisen Bank sh.a. kërkonte

ta jepte atë me qira ose, në të kundërt, (trashëgimtarët) të kompensoheshin për vlerën e truallit sipas VKM-së nr. 704, datë 11.10.2006 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet, si dhe procedurës së shitjes”. Në përgjigje, me shkresën nr. 374/1 prot., datë 22.07.2008, Ministria e Financave i ka bërë të ditur kërkuesit se organi kompetent për kompensimin e pronave është Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Korçë (AKKP). Në vijim, kërkuesi i është drejtuar me kërkesë AKKP-së dhe Ministrisë së Financave, duke kërkuar, ndër të tjera, edhe fillimin e procedurave për anulimin e kontratës së shitblerjes, si veprim juridik absolutisht i pavlefshëm, kërkesë për të cilën nuk ka marrë përgjigje.

4. Në vitin 2013 kërkuesi dhe trashëgimtarët e tjerë të ish-pronarit S.Q. i janë drejtuar gjykatës me kërkesëpadi, duke kërkuar njohjen e së drejtës së parablerjes, pavlefshmërinë absolute të kontratës së shitblerjes për pjesën që përfshin objektin “Agjencia Bankare nr. 2, Korçë” dhe kthimin në gjendjen e mëparshme. Me vendimin nr.1255, datë 27.05.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur kthimin e padisë dhe të akteve, me arsyetimin se ishin të paplota, vendim, i cili, pas ankimit të kërkuesit dhe të paditësve të tjerë, është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Korçë.

5. Në datën 16.12.2014, kërkuesi dhe trashëgimtarët e tjerë të ish-pronarit S.Q., i janë drejtuar sërish gjykatës me kërkesëpadi, me objekt: (i) ndryshimin e pikës 1 të vendimit nr. 336/1994 të KKKP, Korçë, duke i njohur të drejtën e parablerjes paditësve, trashëgimtarëve të ish-pronarit S.Q. për objektin “Agjencia Bankare nr. 2, Korçë”, pronë e ish-Bankës së Kursimeve; (ii) konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitblerjes të Bankës së Kursimeve të Shqipërisë për pjesën që përfshin objektin “Agjencia Bankare nr.2, Korçë, si dhe kthimin në gjendjen e mëparshme; (iii) njohjen e paditësve trashëgimtarë të ish-pronarit S.Q. si pronarë të ambientit “Agjencia Bankare nr. 2, Korçë”, pronë e ish-Bankës së Kursimeve, sot në pronësi të Raiffeisen Bank sh.a., dhe kthimin e saj me vlerën aktuale minimale, minus vlerën e truallit dhe amortizimin për vitet 2004-2014; (iv) fshirjen nga regjistri i pronësisë pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë, të ambientit “Agjencia Bankare nr. 2, Korçë”, në pronësi të Raiffeisen Bank sh.a., si dhe regjistrimin e saj në emër të trashëgimtarëve të S.Q.; (v) dëmshpërblimin e paditësve trashëgimtarë për fitimin e munguar nga lëshimi me qira i ambientit, me një shumë prej 1,980,000 lekësh për periudhën 2004-2014, dëmshpërblim në formën e një qiraje; (vi) shpenzimet gjyqësore, jashtëgjyqësore dhe ato tarifore për regjistrimin e pronësisë së Raiffeisen Bank sh.a. dhe regjistrimin në emër të trashëgimtarëve të ish-pronarit S.Q. t’i ngarkohen

Ministrisë së Financave. Palë të paditura në proces janë thirrur AKKP-ja, Raiffeisen Bank sh.a. dhe Ministria e Financave.

6. Me vendimin nr. 41-2015-1064 (536), datë 16.03.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova. Ndonëse kërkuesi dhe paditësit e tjerë kanë paraqitur ankim, Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 259, datë 06.10.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Kurse Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-209, datë 17.01.2024, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuarit dhe paditësve të tjerë trashëgimtarë të ish-pronarit S.Q., me arsyetimin se në të nuk janë ngritur shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (KPC).

7. Në datën 03.06.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr.8577/2000, është regjistruar më 26.06.2025. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit nr.8577/2000, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuarit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet e kundërshtuara i kanë cenuar:

8.1. *Të drejtën për një proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

8.1.1. *Së drejtës për t’u njoftuar*, pasi Gjykata e Lartë nuk i ka njoftuar për datën e shqyrtimit të çështjes, ndërsa kërkuesi dhe paditësit e tjerë e kanë pasur të pamundur të ndjekin shpalljen e datave të seancës në faqen zyrtare të asaj gjykate për një kohë aq të gjatë, ndërkohë që Kushtetuta njeh të drejtën e ankimit në një gjykatë më të lartë. Për këtë çështje Gjykata e Lartë e ka njoftuar kërkuarin vetëm në muajin mars të vitit 2025, pas kërkesës së tij për përshpejtim të gjykimit të çështjes.

- 8.1.2. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi vendimmarrjet e gjykatave të zakonshme tregojnë se ato e kanë paragjykuar çështjen, sikurse kjo dëshmohet edhe nga mospranimi i kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit të çështjes në gjykatën e shkallës së parë.
- 8.1.3. *Së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi rekursi është shqyrtuar pas më shumë se 10 vjetëve, jo vetëm për shkak të pandemisë ose të reformës në drejtësi, por edhe nga planifikimi jo i drejtë i çështjeve nga Gjykata e Lartë.
- 8.1.4. *Parimit të barazisë përpara ligjit*, pasi gjykatat e zakonshme i kanë mohuar kërkuessit dhe trashëgimtarëve të tjerë ligjorë të ish-pronarit S.Q. të drejtën e gëzimit dhe të posedimit të pronës, duke favorizuar Ministrinë e Financave, Bankën e Kursimeve dhe Raiffeisen Bank sh.a.
- 8.1.5. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi kërkuessit dhe trashëgimtarëve të tjerë të ish-pronarit S.Q., ndonëse iu është njohur pronësia e truallit me vendimin nr. 336/1994 të KKKP-së Korçë, atyre u është mohuar gëzimi dhe posedimi i tij për më shumë se 30 vjet.
- 8.1.6. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka arsyetim të vetin, por ka pranuar arsyetimin e gjykatave më të ulëta, të cilat kanë lejuar shkelje ligjore dhe kushtetuese. Ato, megjithëse pranojnë se kthimi i pronës nuk është mënyrë e re fitimi pronësie, e konsiderojnë të ligjshëm kalimin e pronësisë së truallit, bashkë me ambientin e shërbimit, në favor të Bankës së Kursimeve dhe në vijim të Raiffeisen Bank sh.a., ndonëse të paditurit nuk kanë qenë pronarë të truallit dhe kërkuessi dhe trashëgimtarët e tjerë ligjorë të ish-pronarit S.Q., si pronarë të tij, nuk kanë dhënë pëlqimin për këtë kalim. Qëndrimi i gjykatave se kalimi i pronësisë është bërë me ligjin nr. 7512, datë 10.08.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit” (ligji nr.7512/1991), bie në kundërshtim me vendimin unifikues nr. 24, datë 13.03.2002 (vendimi unifikues nr. 24/2002) të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- 8.2. *Të drejtën e pronës*, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi ndonëse kërkuessi dhe trashëgimtarëve të tjerë të ish-pronarit S.Q. iu është njohur pronësia e truallit me

vendimin nr. 336/1994 të KKKP-së Korçë, atyre iu është mohuar gëzimi dhe posedimi i tij.

- 8.3. *Të drejtën për dëmshpërblim*, të garantuar nga neni 44 i Kushtetutës, pasi mohimi i gëzimit të fryteve të pronës i ka shkaktuar kërkuessit dhe trashëgimtarëve të ish-pronarit S.Q. dëm material dhe moral.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuessit

9. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuessi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Mbledhja e Gjyqtarëve evidenton se gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitetit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkuessin. Në këtë drejtim, mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së kriterëve, me pasojë moskalimin e saj në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kriterëve të tjera. Në rastin kur verifikohet dhe arsyetohet mosplotësimi i vetëm një kriteri, kjo vjen si rezultat i zbatimit të karakterit kumulativ të tyre dhe nuk nënkupton se kriteret e tjera paraprake humbasin rëndësinë që kanë për rezultatin e çështjes, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit kriter që të vendoset moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare (*shih vendimin nr. 112, datë 30.04.2025 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

11. Fillimisht, Kolegji vëren se kërkuessi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t’u njoftuar, së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e

paanshme, së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, parimit të barazisë përpara ligjit, parimit të sigurisë juridike dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, si dhe së drejtës së pronës dhe asaj për dëmshpërblim.

12. Në lidhje me pretendimet e kërkuarit për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, Kolegji çmon të ndalet në analizën e kriterit të shterimit të mjeteve juridike në dispozicion. Gjykata ka pohuar se shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuari, i cili, përpara se t'i drejtohet Gjykatës, duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet juridike efektive të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ i t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Kolegji vëren se në ankimin kushtetues individual kërkuari ka pretenduar cenimin e së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, pasi rekursi është shqyrtuar pas më shumë se 10 vjetëve, jo vetëm për shkak të pandemisë ose të reformës në drejtësi, por edhe nga planifikimi jo i drejtë i çështjeve nga Gjykata e Lartë.

14. Për sa i takon këtij pretendimi, Kolegji vëren se ndryshimet që i janë bërë KPC-së me ligjin nr. 38/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar", kanë përcaktuar, ndër të tjera, se cilat konsiderohen afate të arsyeshme (neni 399/2), cili konsiderohet shpërblim i drejtë (neni 399/3), cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave (nenet 399/4 dhe 399/6), përfshirë rregullat për gjykimin e kërkesës (neni 399/7). Gjykata ka pranuar se, në parim, mjetet e parashikuara nga nenet 399/1 e vijues të KPC-së janë efektive, ndërsa në praktikë efektiviteti i tyre duhet shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret (*shih vendimet nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, individ duhet t'u drejtohet gjykatave të zakonshme, në përputhje me parashikimet e KPC-së, dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, ai mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues (*shih vendimet nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 44, datë 26.09.2023; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar drejtpërdrejt Gjykatës me ankim kushtetues individual, pa paraqitur më parë kërkesë në Gjykatën e Lartë dhe pa shfrytëzuar garancitë e mbrojtjes që, në zbatim të nenit 399/6 të KPC-së, ofron juridiksioni i zakonshëm gjyqësor për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshejtimin e shqyrtimit të çështjes së tij. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se për këtë pretendim kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000.

16. Në lidhje me pretendimet e tjera të kërkuetit, Kolegji çmon të ndalet në kriterin e legjitimit *ratione materiae*.

17. Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për t’u njoftuar me argumentin se Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar për datën e shqyrtimit të çështjes, ndërsa ai dhe paditësit e tjerë e kanë pasur të pamundur të ndjekin shpalljen e datave të seancës në faqen zyrtare të asaj gjykate për një kohë aq të gjatë, ndërkohë që Kushtetuta u ka njohur të drejtën e ankimit në një gjykatë më të lartë. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se e drejta për t’u njoftuar dhe për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, ndërsa kjo e drejtë, ndër të tjera, i krijon një pale ndërgjyqëse të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih vendimet nr. 40, datë 14.09.2023; nr. 8, datë 23.02.2021; nr. 49, datë 22.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në lidhje me procedurat e rekursit, Kolegji vëren se neni 480 i KPC-së parashikon shqyrtimin e tij për kushtet e pranueshmërisë në dhomën e këshillimit. Më tej, në rastin kur rekursi plotëson kushtet e pranueshmërisë, çështja shqyrtohet në seancë gjyqësore, si rregull, në dhomën e këshillimit mbi bazë të dokumenteve (neni 482 i KPC-së) ose në prani të palëve (neni 482/a i KPC-së), shqyrtim për të cilin palët njoftohen për ditën, orën dhe përbërjen e trupit gjykues, të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit, përmes shpalljes në ambientet e Gjykatës së Lartë, si dhe në faqen e saj të internetit dhe me njoftim individual, kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjykimimit.

19. Në rastin në shqyrtim, Kolegji konstaton se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje mbi bazën e rekursit të paditësve, ndër ata edhe kërkuesi. Rekursi është shqyrtuar në dhomën e këshillimit të datës 17.01.2024. Njoftimi për shqyrtimin e çështjes është publikuar në datën 28.12.2024, në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë. Në datën e planifikuar (17.01.2024), Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka shqyrtuar rekursin, duke vendosur mospranimin e tij, mbështetur në

nenin 480 të KPC-së. Kolegji vëren se rekursi i kërkuarit i është nënshtruar shqyrtimit paraprak të pranueshmërisë, shqyrtim ky që lidhet me verifikimin e kushteve formale të paraqitjes së tij dhe të ekzistencës së shkaqeve të lejuara nga ligji, qoftë në aspektin formal, ashtu edhe në atë substancial, duke u mbështetur në aktet e dosjes gjyqësore. Po kështu, ndonëse ligji procedural nuk parashikon shprehimisht njoftimin e palëve për shqyrtimin paraprak të rekursit, në rastin konkret ato janë njoftuar në një nga mënyrat e parashikuara nga ligji. Në kontekst të rrethanave të rastit konkret, Kolegji vlerëson se kërkuari ka ushtruar lirisht të drejtën e ankimit në një gjykatë më lartë, të rekursit në këtë rast, ndërkohë që për sa i përket cenimit të pretenduar të së drejtës për t'u njoftuar nga Gjykata e Lartë, ai nuk ka parashtruar mjaftueshëm argumente sesi ajo mënyrë njoftimi nga ana e asaj gjykate mund dhe ka passjellë në realitet cenimin e ndonjë të drejte procedurale të lidhur dhe të ndërruar nga ajo. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkuarit nuk mund të merret në shqyrtim.

20. Kërkuari ka pretenduar cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme me argumentin se vendimmarrjet e gjykatave të zakonshme tregojnë se ato e kanë paragjykuar çështjen, sikurse kjo dëshmohet dhe nga mospranimi i kërkesës për përjashtim të gjyqtarit të çështjes në gjykatën e shkallës së parë. Gjykata ka theksuar se respektimi i së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme duhet të verifikohet duke zbatuar dy teste, testin subjektiv, i cili, në thelb, kërkon të provuarit e faktit se bindja personale e një gjyqtari ka ndikuar në vendimin e gjykatës dhe gjithashtu testin objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. Në kuptim të testit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta. Për sa i përket testit objektiv, ai nënkupton se veç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues duhet të provohet nëse ka fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë (*shih vendimet nr. 10, datë 12.04.2022; nr. 10, datë 13.02.2017; nr. 49, datë 10.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në rastin konkret, nga aktet bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, Kolegji konstaton se kërkuari ka kërkuar përjashtimin e gjyqtarit të çështjes në gjykatën e shkallës së parë me pretendimin se nuk ka lejuar zhvillimin e një hetimi të plotë gjyqësor, konkretisht kërkimin nga pala e paditur të praktikës dokumentare të tenderit të hapur ndërkombëtar për privatizimin dhe shitjen e aksioneve të Bankës së Kursimeve sh.a., si dhe se ka treguar njëanshmëri dhe paragjykim pasi ka përmendur vetëm nenet e ligjit, por nuk i ka lexuar ato. Kjo kërkesë është shqyrtuar nga një gjyqtar tjetër i asaj gjykate dhe me vendimin nr. 131, datë 02.03.2015, ajo është rrëzuar, me arsyetimin se nuk vërtetohet asnjë nga rastet e parashikuara në nenin 72 të KPC-së ose ndonjë

arsye serioze njëanshmërie në kuptim të pikës 6 të këtij neni dhe se gjyqtari i çështjes nuk rezulton të ketë dhënë opinion ose ketë mbajtur qëndrim subjektiv për çështjen. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe gjykata e apelit, e cila ka vlerësuar se edhe vendimet e ndërmjetme të gjykatës për kërkesat e palëve për marrjen dhe administrimin e provave janë në funksion të mbarëvajtjes së procesit gjyqësor, duke qenë në kompetencë të asaj gjykate, ndërkohë që për përjashtimin e gjyqtarit është e rëndësishme që pala të provojë se veprimet e tij janë bërë në kundërshtim me dispozitat procedurale civile që rregullojnë aspektet e vendimmarrjes së gjykatës. Në rastin konkret, nuk provohet që gjyqtari i çështjes të ketë treguar njëanshmëri në marrjen dhe administrimin e provave dhe, për më tepër, hetimi ose jo i plotë i çështjes, sipas ligjit, nuk përbën shkak për përjashtimin e gjyqtarit. Kurse Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se ligji procedural është respektuar.

22. Kolegji vëren se kërkesa e kërkuarit për përjashtimin e gjyqtarit të çështjes në gjykatën e shkallës së parë i është nënshtruar shqyrtimit sipas ligjit dhe gjykatat u kanë dhënë përgjigje të arsyetuara pretendimeve të tij. Nisur nga kjo, si dhe për sa kohë në ankimin e tij kushtetues individual kërkuari nuk ka parashtruar ndonjë argument konkret në nivel kushtetues për pretendimin për njëanshmërinë e gjyqtarëve që kanë gjykuar çështjen e tij, Kolegji vlerëson se vetëm fakti se ata kanë vendosur për rrëzimin e padisë, nuk mund të vërë në dyshim respektimin e parimit të paanshmërisë. Për rrjedhojë, edhe ky pretendim i kërkuarit nuk mund të merret në shqyrtim.

23. Për sa u përket pretendimeve të kërkuarit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në drejtim parimit të barazisë përpara ligjit, parimit të sigurisë juridike dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, si dhe së drejtës së pronës dhe asaj për zhdëmtim, Kolegji vëren se, në thelb, ato kanë të bëjnë me pretendimet e kërkuarit për vendimmarrjet e gjykatave të zakonshme, të cilat kanë rrëzuar padinë e tij. Nisur nga kjo, pretendimet e kërkuarit do të analizohen në këndvështrim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

24. Konkretisht, kërkuari ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk ka arsyetim të vetin, por ka pranuar arsyetimin e gjykatave më të ulëta, të cilat kanë lejuar shkelje ligjore dhe kushtetuese. Sipas tij, gjykatat e faktit, megjithëse pranojnë se kthimi i pronës nuk është mënyrë e re fitimi pronësie, konsiderojnë të ligjshëm kalimin e pronësisë së truallit, bashkë me ambientin e shërbimit, në favor të Bankës së Kursimeve dhe, në vijim, të Raiffeisen Bank sh.a., ndonëse të paditurit nuk kanë qenë pronarë të truallit dhe kërkuari dhe trashëgimtarët e tjerë ligjorë të ish-pronarit S.Q., si

pronarë të tij, nuk kanë dhënë pëlqimin për këtë kalim. Po sipas kërkesit, qëndrimi i atyre gjykatave se kalimi i pronësisë është bërë me ligjin nr. 7512/1991, bie në kundërshtim me vendimin unifikues nr. 24/2002 të Gjykatës së Lartë. Ai shprehet se ndonëse atij dhe trashëgimtarëve të tjerë ligjorë të ish-pronarit S.Q. iu është njohur pronësia e truallit me vendimin nr. 336/1994 të KKKP-së, Korçë, atyre u është mohuar gëzimi dhe posedimi i tij, përveç edhe gëzimi i fryteve të pronës, gjë që ka shkaktuar dëm material dhe moral.

25. Gjykata është shprehur se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 79, datë 14.12.2017; nr. 63, datë 23.09.2015; nr. 3, datë 26.01.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Gjithsesi, zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata, rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes dhe natyrës së vendimit, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 79, datë 14.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Në lidhje me vendimet e Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit, Gjykata ka pohuar se ato mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015; nr. 37, datë 19.09.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Nga ana tjetër, Gjykata ka pohuar se problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues nëse nuk shoqërohen

me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Mënyra sesi gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim përpara tyre nuk përbën lëndë kushtetuese, me përjashtim të rastit kur kjo mënyrë veprimi e gjykatës së zakonshme provohet se ka cenuar të drejta kushtetuese të individit që vë në lëvizje këtë Gjykatë, në kuptimin që procesi në tërësinë e tij rezulton haptazi i paarsyeshëm ose arbitrar (*shih vendimin nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Në çështjen në shqyrtim, Kolegji vëren se padia e kërkuarit dhe e trashëgimtarëve të tjerë të ish-pronarit S.Q. është rrëzuar nga gjykata e shkallës së parë. Në lidhje me kërkimin e parë të padisë, atij për ndryshimin e pikës 1 të vendimit nr. 336/1994 të KKKP, Korçë dhe njohjen e së drejtës së parablerjes trashëgimtarëve të ish-pronarit S.Q. për objektin “Agjencia Bankare nr. 2, Korçë”, ajo gjykatë ka arsyetuar se disponimi i KKKP-së, Korçë, për njohjen e së drejtës së pronësisë të ish-pronarit dhe kompensimin me letra me vlerë të trashëgimtarëve të tij është në përputhje me ligjin e kohës, me atë nr. 7698/1993. Sipas saj, ndonëse ky ligj nuk përbën një formë të re të fitimit të pronësisë, trualli, në rastin konkret, ka qenë i zënë në kuptim të ligjit pasi mbi të ka pasur ndërtime të përhershme, ndaj me të drejtë komisioni i pronave nuk ka disponuar për kthimin e tij trashëgimtarëve të ish-pronarit, por kompensimin e tyre me letra me vlerë. Për sa i përket së drejtës së parablerjes të pretenduar nga paditësit, ajo gjykatë ka arsyetuar se trashëgimtarët e ish-pronarit nuk kanë kërkuar asnjëherë më parë njohjen e kësaj të drejte, çka tregon se ata kanë vlerësuar që kjo e drejtë nuk u takon ose nuk e kanë dashur atë. Gjithsesi, vijon gjykata, ndërsa sipas 21 të ligjit nr. 7698/1993 kjo e drejtë njihet në ato raste kur trojet janë të zëna me ndërtime shtetërore dhe e drejta e parablerjes realizohet kur ndërtimet privatizohen, në rastin konkret objekti për të cilin kërkohet e drejta e privatizimit nuk është më objekt shtetëror, pasi ai është privatizuar në vitin 2004, pra përpara më shumë se 11 vjetësh nga ngritja e padisë. Për më tepër, sipas gjykatës, objekti i ka kaluar në pronësi Bankës së Kursimeve sh.a. në kohën e krijimit të saj në vitin 1991, bazuar në ligjin 7512/1991, pra përpara daljes së ligjit nr. 7698/1993, që njohu të drejtën e kthimit dhe të kompensimit të pronës për ish-pronarët, përfshirë edhe të drejtën e parablerjes, mbi të cilin KKKP-ja, Korçë, në vitin 1994, disponoi në favor të paditësve. Në këtë rrethana, shprehet ajo, edhe nëse objekti nuk do t’i kishte kaluar Bankës së Kursimeve sh.a., nisur nga fakti se ai është privatizuar në vitin 2004, duke i kaluar në pronësi Raiffeisen Bank sh.a., gjykata nuk mund të disponojë për njohjen paditësve të së drejtës së parablerjes për një objekt që është pronë

private, për sa kohë kjo e drejtë, sipas ligjit, mund të njihet vetëm për ndërtesat pronë shtetërore të paprivatizuara.

29. Për sa i përket kërimit të dytë të padisë, atij për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitjes të objektit “Agjencia Bankare nr. 2, Korçë” në favor të Raiffeisen Bank sh.a. dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se ky kërkim është i lidhur dhe i ndërruar nga kërkitimi i parë i padisë, ndaj pëson fatin e tij. Sipas saj, paditësit nuk provojnë interesin e ligjshëm për kërkimin e dytë të padisë, përveçse as qenien e asaj kontrate shitjeje një veprim juridik absolutisht të pavlefshëm. Për rrjedhojë, vijon ajo gjykatë, për sa kohë kërkimet kryesore të padisë janë të pabazuara, edhe kërkimet e tjera të saj janë të tilla, për shkak se ato janë të lidhura dhe të ndërruara. Paditësit nuk mund të kërkojnë njohjen pronarë, kthimin e sendit dhe shpërblimin për fitimin e munguar, për sa kohë nuk kanë pasur dhe as kanë ndonjë të drejtë mbi sendin, i cili është në pronësi të Raiffeisen Bank sh.a.

30. Çështja në vijim, për ankimin e kërkuar dhe të trashëgimtarëve të tjerë të ish-pronarit S.Q., është shqyrtuar nga gjykata e apelit, e cila ka rritur në një përfundim të njëjtë me gjykatën e shkallës së parë, duke vlerësuar se zgjidhja nga ajo e mosmarrëveshjes është e drejtë dhe ligjore, në përputhje me ligjin material të detyrueshëm për zbatim në atë rast, ndërsa pretendimet në ankim të paditësve nuk janë të bazuara ligjërisht, përveçse kanë marrë përgjigje në vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Po kështu, çështja i është nënshtruar edhe kontrollit nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur mospranimin e rekursit të paditësve me arsyetimin se në të nuk ngrihen shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së. Sipas atij kolegj, gjykata e apelit ka respektuar ligjin procedural dhe atë material, duke i interpretuar dhe zbatuar drejt ato, vendimi i saj nuk bie në kundërshtim me ndonjë vendim të Kolegjit Civil ose Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si dhe se nuk konstatohen shkelje të rënda të normave procedurale, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit ose të procedurave të gjyqimit.

31. Nga sa më lart, referuar përmbajtjes së vendimeve gjyqësore objekt kërkesë, Kolegji vëren se vendimet e gjykatave të faktit përmbushin mjaftueshëm elementet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Ato kanë analizuar dhe përcaktuar faktet me rëndësi për çështjen, sikundër edhe ligjin e zbatueshëm. Vendimet nuk shfaqin alogjizëm, parregullsi në formë dhe paqartësi në përmbajtje. Argumentet e pjesës arsyetuese janë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke formuar një përmbajtje koherente brenda vendimit dhe të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese të vendimeve.

32. Në këtë drejtim, Kolegji vëren se, sikurse kërkuesi pretendon në vendimin e gjykatës së shkallës së parë, arsyetohet se kthimi i pronave sipas ligjit nr. 7698/1993 nuk është formë e re e fitimit të pronësisë, por megjithatë ky arsyetim është bërë në funksion të verifikimit të mundësisë së rivendosjes së plotë të kësaj të drejte përmes kthimit fizik të truallit, gjë për të cilën, sikurse edhe komisioni i pronave ka konkluduar, të dyja gjykatat e faktit kanë pranuar se në rastin konkret kjo është e pamundur për shkak se trualli ka qenë i zënë në kuptim të ligjit, ndaj me të drejtë trashëgimtarët e ish-pronarit janë kompensuar për vlerën e tij sipas ligjit të kohës, me letra me vlerë. Thënë këtë, arsyetimi i gjykatave nuk duket se ka kontradiktë me përfundimin se tyre se paditësit nuk gëzojnë të drejtën e pronësisë mbi truallin dhe as mbi objektin “Agjencia Bankare nr. 2, Korçë”, se ata nuk kanë interes të ligjshëm për të kërkuar pavlefshmërinë absolute të kontratës së shitjes në favor të Raiffeisen Bank sh.a., ose që ky veprim juridik nuk bie në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit, sikundër edhe për të kërkuar njohjen e tyre pronarë për këtë objekt dhe shpërblimin për përdorimin e tij.

33. Po kështu, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, Kolegji vëren se nuk duket që qëndrimi i atyre gjykatave të jetë në kundërshtim me vendimin unifikues nr. 24/2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të cilat, në interpretim të ligjit nr. 7698/1993, krahas përfundimit se ky ligj nuk është një mënyrë e re e fitimit të pronësisë, por korrigjim i padrejtësisë së bërë, kanë theksuar se ai ka shfuqizuar *ipso lege* të gjitha aktet e mëparshme ligjore me të cilat pronarëve u ishte marrë prona padrejtësisht, shfuqizim i cili ka si efekt kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme, duke rregulluar në masën më të mundshme situatën e paligjshmërisë për të drejtën reale të pronësisë dhe se ky kthim nuk është i plotë, por i pjesshëm (*restitutio in parte*). Po sipas tyre, përmes këtij ligji njihet e drejta e pronësisë ish-pronareve ose trashëgimtarëve të tyre dhe përcaktohen modalitetet për gëzimin efektiv të saj, por për shkak të kohës së gjatë të paligjshmërisë dhe pamundësisë objektive të kthimit fizik të të gjitha pronave të marra, ligji parashikon për rastet kur kjo e para nuk është e mundur (kthimi fizik), alternativën e kompensimit.

34. Për sa i përket vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, Kolegji vëren se, ndonëse me arsyetim të kufizuar, paraqitet i rregullt në formë dhe pasqyron rrethanat e çështjes, shkaqet e ankimit, si dhe pjesën arsyetuese. Në ndryshim nga sa pretendon kërkuesi, Gjykata e Lartë, me arsyetim të kufizuar, ka analizuar pretendimet e tij, duke konkluduar se vendimmarrja e gjykatës së apelit ishte në përputhje me ligjin material dhe atë procedural dhe se në këto kushte nuk kishte vend për cenimin e tij. Ndaj, për rrjedhojë, në kontekstin konkret, nuk rezulton që arsyetimi i

kufizuar i Gjykatës së Lartë të bjerë ndesh me thelbin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, sipas të cilit kërkuesi duhet të marrë përgjigje për pretendimet kryesore të tij për zbatimin ose interpretimin e ligjit, si kompetencë e kësaj gjykate. Gjithashtu, po në këtë drejtim, Kolegji thekson se, në tërësinë e tij, vendimi i Gjykatës së Lartë nuk rezulton të jetë alogjik, kontradiktor ose i paqartë.

35. Nga ana tjetër, Kolegji vëren se nga kërkuesi nuk argumentohet se zbatimi i ligjit nga gjykatat e zakonshme ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës, ndaj vetëm fakti se në përfundim të procesit gjyqësor, në të cilin palët kanë pasur mundësinë të ushtrojnë garancitë e tyre procedurale, gjykatat kanë dhënë një vendim jo në favor të tij, nuk është i mjaftueshëm për të provuar cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

36. Nisur nga sa më lart, Kolegji vlerëson se vendimet gjyqësore të kundërshtuara nga kërkuesi nuk cenojnë standardin e arsyetimit, ndaj, për pasojë, pretendimi i tij është haptazi i pabazuar.

37. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.